



SEECP ALBANIAN CHAIRMANSHIP
REGIONAL OWNERSHIP IN ACTION

Priorities of the Albanian SEECP Chairmanship-in-Office

Gjatë Kryesisë së Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Republika e Shqipërisë do të kontribuojë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis të gjithë pjesëmarrësve në këtë organizatë. Shtimi i bashkëpunimit është çelësi për tejkalimin e çështjeve madhore bilaterale dhe të brendshme, gjë që do të kontribuojë në mënyrën se si SEECP dhe pjesëmarrësit në këtë organizatë do të përballen me sfidat e stabilitetit dhe sigurisë në rajon. Kryesia Shqiptare e SEECP-së do të punojë ngushtë me BE-në dhe vendet anëtare në të për të mbajtur gjallë procesin e integritetit evropian për ato vende të SEECP-së që aspirojnë për tu bërë anëtarë të BE-së. Ne do të mbështesim dhe zhvillojmë më tej projektet e përbashkëta rajonale, disa prej të cilave u identifikuan së fundi në Konferencën e Berlinit mbi Ballkanin Perëndimor në 28 gusht 2014.

Kryesia Shqiptare do të udhëhiqet nga parimet e mishëruara në Kartën e SEECP-së, Deklaratat e Samiteve të SEECP-së, si dhe vendimet e marra nga Ministrat e SEECP-së dhe do të ndjekë programet dhe aktivitetet e Presidencave të mëparshme duke bashkëpunuar ngushtësisht me Trojkën e SEECP-së, Sekretariatit e RCC si dhe me të gjithë vendet pjesëmarrëse të SEECP-së.

Gjatë kryesimit, prioritetet e Shqipërisë do të fokusohen në tre shtylla:

I. Forcimi i rolit rajonal të SEECP-së

- Promovimi i parimit të fqinjësisë së mirë përmes intensifikimit të bashkëpunimit rajonal në fushat politike, të sigurisë, tregtisë, kulturës dhe arsimit.
- Konsolidimi i parimit të gjithëpërfshirjes në bashkëpunimin rajonal, me qëllim sigurimin e kontributit aktiv dhe të plotë të të gjithë pjesëmarrësve në SEECP,

në të gjitha nivelet dhe në terma të barabartë, kështu që, duke ndjekur Deklaratën e Samitit të SEECP-së të Bukureshtit, të mirëpresim Kosovën* si anëtare të organizatës.

- Kryesia Shqiptare është e gatshme të ofrojë kontributin e saj në forcimin e bashkëpunimit për krijimin dhe inkurajimin e klimës si dhe duke përdorur indikacionin pozitiv të fqinjësisë së mirë për zgjidhjen e çështjeve dypalëshe dhe kalimin e vështirësive të brendshme sa më shpejt të jetë e mundur. Siç edhe u ra dakord nga të gjithë pjesëmarrësit në Konferencën e Berlinit, gjithashtu të gjithë ne duhet të ndihmojmë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjeve dypalëshe në rajonin tonë.
- Forcimi i dialogut institucional me Komisionin Evropian dhe institucione të tjera të BE-së për të promovuar perspektivën Evropiane të vendeve anëtare të SEECP, që ende nuk janë anëtare të BE. Ne presim mbështetjen e plotë të të gjithë vendeve të BE-së brenda organizatës sonë në këtë drejtim. Konferenca e Berlinit duhet të vë në lëvizje politikatat e zgjerimit nëpërmjet përpjekjeve të përforcuara për progres në reforma dhe në pajtim nga ana jonë, si dhe nëpërmjet një kursi të besueshëm dhe të parashikueshëm nga ana e BE-së. Ka shumë rëndësi që BE ruaj fokusin në procesin e integritetit. Ne riafirmojmë rëndësinë e zgjerimit të BE-së për suksesin e procesit të reformave në vendet tona dhe për sigurinë dhe prosperitetin e BE-së në tërësi.
- Shqipëria si Kryesi e SEECP-së do të punojë ngushtë me formatet e tjera të bashkëpunimit rajonal, veçanërisht në kuadër të Ballkanit Perëndimor.
- Kryesia jonë do të inkurajojë të gjithë vendet pjesëmarrëse të SEECP-së që të punojnë ngushtë me BE-në në të gjithë fushat me interes të përbashkët si dhe të bashkërendohet me BE-në mbi çështje të politikës së jashtme.
- Shqipëria do të vazhdojë të promovojë SEECP-në në nivel kombëtar dhe në nivel ndërkombëtar, si një zë unik i rajonit dhe partner i besueshëm i komunitetit ndërkombëtar.

Kalendari i aktiviteteve ka parashikuar tre takime të Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare, një Samit të Kryetarëve të shteteve\qeverive, takime të Asamblesë Parlamentare të SEECP-së, disa takime të Drejtorëve Politikë dhe të Trojkës.

* *This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of independence.*

II. Promovimi i dialogut ndërmjet vendeve anëtare për përmirësimin e funksionimit të SEECP-së

Diskutimet në proces për forcimin e rolit të SEECP-së janë shenja të qarta të përgjegjësisë dhe pronësisë rajonale.

- Shqipëria do të koordinojë dhe lehtësojë, së bashku me RCC-në, takimet e *Grupit Ad-Hoc të Punës*, të krijuar për përmirësimin e funksionimit të SEECP-së, në mënyrë që të kemi një dokument gjithëpërfshirës, me qëllim që ta miratojmë në fund të Kryesisë.
- Gjatë Kryesisë Shqiptare, duke qenë se mandati i Sekretarit të Përgjithshëm të RCC-së mbaron, do të mbahen dhe përmbillen procedurat e zgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm të RCC-së.

III. Konsolidimi i rëndësisë sektoriale të SEECP-së

Axhenda sektoriale e Kryesisë Shqiptare do të synojë promovimin e fushave me interes të përbashkët të vendeve anëtare, duke mbajtur parasysh dhe duke u bazuar në “Strategjinë e Evropës Juglindore 2020” (SEE 2020) dhe veçanërisht fushat e bashkëpunimit të diskutuara në Konferencën e Berlinit.

Gjatë Kryesisë Shqiptare, kalendari i aktiviteteve do të përfshijë këto fusha kryesore bashkëpunimi:

- Promovimi i bashkëpunimit në sigurinë e energjisë në hapësirën ekonomike të SEECP-së, me qëllim përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji, diversifikimin e burimeve energjitike, si dhe zhvillimin e infrastrukturës energjitike dhe rritjen ndërlidhjes; mbështetje për TAP-in dhe IAP-in; zhvillimi i mëtejshëm i Komunitetit Energjitik dhe tejkalimi i mangësive në implementim.
- Mbështetje ndaj përpjekjeve rajonale për përmirësimin e ndërlidhjes në rajon, veçanërisht për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës, si autostrada Adriatioko-Joniane ose ndërtimi qendrave të logjistikës për porte multi-modale.
- Përkrahje e zhvillimit ekonomik, tregtisë dhe promovimi i investimeve në bashkëpunim të ngushtë, ndërkohë që kihet ndërmend Strategjia e Evropës Juglindore 2020.

- Promovimi i bashkëpunimit rajonal në turizëm dhe inkurajimi i ofertave të përbashkëta.
- Bashkëpunim i zgjeruar në agrikulturë, transferim dijesh dhe teknologjie nga vende më të përparuara të rajonit dhe BE-së.
- Mbështetje trashëgimisë kulturore dhe promovimi i harmonisë fetare.
- Inkurajimi i kërkimit dhe inovacionit shkencor.
- Zgjerimi i bashkëpunimit të instituteve të statistikave, transferim dijesh dhe ekspertize, veçanërisht në kornizën EJ 2020 monitorimi dhe mbledhja e të dhënave.
- Promovimi i bashkëpunimit parlamentar për institucionalizimin e mëtejshëm, si një Asamble Parlamentare e SEECP-së.
- Promovimi i bashkëpunimit rajonal të Trupave Rregullator të Pavarur (Independent Regulatory Bodies), me vëmendje të veçantë Institucionet e Ombudsmanëve në rajon.
- Promovimi i bashkëpunimit në fushat e drejtësisë dhe punëve të brendshme në rajon, veçanërisht në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Kalendari i aktiviteteve parashikon 2-3 ministeriale të nivelit të lartë dhe më shumë se 10 aktivitete në nivel ekspertësh. Aktivitetet do të organizohen në bashkëpunim të ngushtë me RCC-në si krahu operativ i SEECP-së.